



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3
21.11.2012

NR. VENDIMI 9
30.10.2013

VENDIM

PËR KONFISKIM E PASURIE

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e përbërë prej:

Luan HASNEZIRI – Gjyqtar

Fran PRENDI – Gjyqtar

Dritan HALLUNAJ - Gjyqtar

asistuar nga sekretare Lavdie HYSAJ, në Tiranë, sot me datë 30.10.2013,
përfundoi çështjen me palë:

KËRKUES:

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë për Krime të Rënda, Tiranë, përfaqësuar
nga prokurori Enend Nakuçi.

KUNDËR:

1. F.H., i biri i Xh. dhe i T., i datëlindjes xxx,
me banim në xxx, zhvilluar gjykimi ndaj tij në

mungesë, përfaqësuar nga avokati i caktuar kryesisht nga gjykata, avokat A.Dh..

2. T.H. (H.), e bija e N. dhe e M., e datëlindjes xxx, me banim në xxx, e pranishme në gjykim, përfaqësuar nga avokatët e zgjedhur prej saj me deklaram në seancë gjyqësore, avokatët A.V. dhe B.R.

OBJEKTI:

Konfiskimin e pasurive të më poshtëme:

1. Apartamentit me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja “xxx”, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e xxx të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx” sh.p.k, me administrator E.Xh., blerë më datë xxx, nga T.H., në shumën prej xxx euro.

2. Pasurisë truall, me sipërfaqe xxx m², me numër regjistri hipotekor nr.xxx, datë xxx, në emër të T.H. Pasuria ka numrin xxx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx komuna xxx, rrethi xxx.

3. Pasuri e tipit Karburant me sipërfaqe xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr.xx, datë xxx, si dhe vendimi nr.xx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të karburantit në posedim të T.H., siç janë: ambjent bosh, ambjenti garazh, palestra që gjendet ngjitur me garazhin, ambjent bar-kafe, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për
*Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të
Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet
Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.*

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, adminstroi provat, dëgjoi në diskutimin përfundimtar prokurorin, i cili, kërkoi:

1. Pushimin e gjykimit të kërkesës për konfiskim, në lidhje me pasuritë:

a) Apartament me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja “xxx”, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e dhjetë të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx”, sh.p.k me administrator E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx, në shumën prej xxx euro.

b) Pasuri truall, me numër regjistri hipotekor nr. xxx, datë xxx, në emër të të paditurës T.H., me numër xxx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m², e ndodhur në komunën xxx, rrethi xxx.

c) Pasuri e tipit Karburant, me sip. xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të karburantit, në posedim të të të paditurës T.H., ambjent bosh, ambjenti garazh, palestra që gjendet ngjitur me garazhin, ambjent bar-kafe, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre.

2. Revokimin e sekuestros për pasurinë e paluajtshme për objektet:

a) Apartament me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja “xxx”, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e dhjetë të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx”, sh.p.k me administrator E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx, në shumën prej xxx euro.

b) Pasuri truall, me numër regjistri hipotekor nr. xxx, datë xxx, në emër të të paditurës T.H., me numër xxx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m², e ndodhur në komunën xxx, rrethi xxx.

c) Pasuri e tipit Karburant, me sip.xxx m2, ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xxx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të karburantit, në posedim të të paditurës T.H., ambjent bosh, ambjenti garazh, palestra që gjendet ngjitur me garazhin, ambjent bar-kafe, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre.

3. Konfiskimin e pajisjeve të përshkruara në praktikën doganore me nr.xxx, xxx., datë xxx në emër të të paditurit F.H., në të cilën përfshihen, konkretisht, këto sende të luajtshme:

*3x tapis roulant Life Fitness 95ti

*3x pajisje për vrap Life Fitness 95xi

*3x biçikleta Life Fitness 95ci

*3x pajisje aerobike Life Fitness 95si

1x pajisje për muskujt e barkut

1x pajisje për forcimin e krahëve

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të krahëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të gjoksit

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të muskujve të gjoksit

1x pajisje për forcim të tricepseve ulur

1x pajisje për forcimin e kofshëve

1x pajisje për forcimin e kofshëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të gjoksit

1x pajisje për forcimin e muskujve të shpinës me tërheqje

1x pajisje për forcimin e muskujve të këmbëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të ulët të shpinës

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të kofshëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të kraharorit

1x pajisje për muskujt e kraharorit/dhe të shpinës

1x pajisje për forcimin e muskujve të jashtëm të këmbëve ulur

1x pajisje për forcimin e muskujve të brendshëm të këmbëve ulur 1 x pajisje

për forcimin e muskujve të shpinës ulur

1x pajisje për forcimin e muskujve të shpatullës

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të krahëve me tërheqje 1x pajisje force për ngritje peshash të rënda

5x stola

1x stol për muskujt e barkut

1x mbajtëse peshash dhe shufrash 1x2.5kg-50kg pesha dhe mbajtëse.

4. Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet **z. A.H.**, i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave - Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit - xxx.

5. Shpenzimet procedurjale si dhe shpenzimet gjyqësore ti ngarkohen personave të paditur T.H. dhe F.H.

Pasi dëgjoi avokatin e caktuar kryesisht për shtetasin F.H., avokatin A.Dh. i cili, ishte dakort me kërkesën e prokurorit për heqjen dorë nga gjykimi për pjesën e kërkesës që kishte të bënte me sendet e paluajtshme dhe kërkoi rrëzimin e kërkesës së prokurorit për konfiskimin e sendeve të luajtshme;

Pasi dëgjoi mbrojtësin e zgjedhur nga vetë shtetasja T.H., avokat A.V., i cili, ishte dakort me kërkesën e prokurorit për heqjen dorë nga gjykimi për pjesën e kërkesës që kishte të bënte me sendet e paluajtshme dhe kërkoi rrëzimin e kërkesës së prokurorit për konfiskimin e sendeve të luajtshme;

VËREN:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me datë xxx, ka paraqitur për gjykim kërkesën kundër shtetasve F.H. dhe T.H., me objekt konfiskimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, sipas listës së cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Përpara se gjykata të parashtrori rrethanat e faktit të këtij gjykimi të llojit të veçantë, “siu generis”, çmon të sqaroi se, procesi i gjykimit zgjati për një periudhë të gjatë kohe, për shkaqe që nuk varen nga vullneti i gjykatës, duke qenë se, shtetasi F.H., ndodhej jashtë shtetit, konkretisht, i arrestuar në burgun xxx, xxx, xxx.

3. Në këto kushte, gjykata, në respektim të parimit kushtetues, sipas të cilit, kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet, si dhe në respektim të normave proceduriale, në rastin konkret, të dispozitave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, të cilat janë të zbatueshme në këtë rast, vendosi që njoftimin për shtetasin F.H., ta bëjë me anë të letërporosisë dërguar autoriteteve gjyqësore të xxx.

4. Nga ana tjetër, shtetasja T.H., u paraqit në gjykim që në seancën e parë gjyqësore, dhe deklaroi para gjykatës se, nuk dëshironte që të merrte pjesë, personalisht, në gjykim, nga fillimi, deri në përfundimin e tij, por, do të përfaqësohej nga mbrojtësit e zgjedhur prej saj, së bashku ose veç e veç, avokatët A.V. dhe B.R., dhe në këto kushte, kjo shtetase konsiderohet si e pranishme në gjykim, duke u përfaqësuar nga mbrojtësit e saj.

5. Pas dërgimit të letërporosisë nga gjykata për njoftimin e shtetasit F.H., gjykimi i kësaj çështje u shty, për disa seanca dhe për një periudhë disa mujore, derisa, më në fund, ky njoftim erdhi, nga ku, rezultoi se, shtetasi F.H., refuzonte që të merrte njoftimin, duke u shprehur se, ishte në dijeni të procesit që zhvillohej ndaj tij, në Shqipëri, por, nuk dëshironte që të merrte njoftimin në lidhje me këtë gjykim, fakt ky i vertetuar, rregullisht, nga autoritet kompetent i xxx.

6. Pas vertetimit të këtij fakti, gjykata, në bazë të paragrafit të fundit të nenit 130 të Kodit të Procedurës Civile, e konsideroj të kryer njoftimin sipas

regullave procedurale, por, duke qenë se, ky lloj gjykimi, nuk është një gjykim me karakter të pastër civil, por, është një gjykim me karakter të veçantë “siu generis”, gjykata, në këtë rast, është e detyruar që të respektojë parashikimet e bëra nga pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 10 192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

7. Në zbatim të parashikimit të bërë nga pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 10 192 datë 03.12.2009, duke qenë se, shtetasi F.H., ndodhej jashtë shtetit dhe refuzoi marrjen e njoftimit, gjykata, vendosi të deklaroi mos gjetjen e tij, si dhe t’i caktojë një avokat kryesisht, në mëngesë të avokatit të zgjedhur prej tij ose familjarët e tij, duke caktuar kryesisht avokatin A.Dh. dhe vijoi gjykimin, në të gjitha seancat gjyqësore, në prani të këtij avokati, i cili, përfaqësoi në gjykim interesat e shtetasit F.H.

8. Nga aktet dhe provat e shqyrtuara, rezultoi se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në bazë të materialit të ardhur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxx dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, ka regjistruar procedimin pasuror, nr. xx, ndaj shtetasve F.H., T.H., A.H., P.H., si dhe personave të tjerë të lidhur me to.

9. Në Prokurorinë për Krime të Rënda, Tiranë, më datë xxx, kanë ardhur materialet e dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxx, me shkresën nr. xxx Prot, datë xxx, me qëllim verifikimin e pasurive në ngarkim të shtetasve F.H. dhe A.H., lindur dhe banues në xxx.

10. Gjithashtu, në datën xxx, në Prokurorinë për Krime të Rënda, Tiranë, me shkresën nr.xxx prot.xxx, datë xxx, të Prokurorisë së Përgjithme, ka ardhur kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale të autoriteteve xxx të drejtësisë. Kësaj kërkesë i është dhënë rrugë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën nr.xxx, datë xxx, me objekt kryerjen e veprimeve procedurale, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në lidhje me shtetasin shqiptar F.H.

11. Nga aktet e kësaj letërporosie ka rezultuar se, Policia e xxx, aktualisht, po heton subjektet F.H., i datëlindjes xxx, M.A.C, P.R.B., S.F., G.A.R. për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes së narkotikëve, parashikuar nga legjislacioni ynë nga neni 283 të Kodit Penal. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. xxx, datë xxx, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është “lejuar ekzekutimi i letërporosisë” së autoriteteve gjyqësore xxx. Po ashtu, nga agjensia xxx e luftës kundër narkotikëve, xxx janë dërguar, tre informacione, të datave xxx, xxx dhe xxx, të përcjella në Policinë e Shtetit, nëpërmjet Oficerit të Kontaktit, pranë Ambasadës xxx në xxx. Sipas tyre, shtetasi F.H., është arrestuar në vitin xxx, në xxx

12. për zotërim drogash të klasit “A”, në vitin xxx, ky shtetas është arrestuar për vjedhje me dhunë, në vitin xxx, është dënuar penalisht nga gjykata për të rinj, me gjobë, për vjedhje.

13. Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton se, në xxx e xxx dhe në xxx, ka disa pasuri të regjistruara, në emrin e shtetasit F.H. dhe familjarëve të tij, si dhe

janë dërguar disa shuma parash, në xxx, të cilat janë tërhequr nga nëna e tij, shtetasja T.H.

14. Nga aktet e administruara, rezulton, po ashtu se, më datë xxx, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, xxx ka, regjistruar procedimin penal me nr. xxx, për veprën penale të: *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”*, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Kjo çështje është regjistruar mbi bazën e referimit të materialeve nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, xxx sipas të cilit, rezultonte se, ndaj shtetasve A. dhe F.F., të cilët janë vëllezër, kishte dyshime për pastrim parash, pasi kishin kryer një numër të konsiderueshëm transfertash bankare.

15. Gjthashtu rezulton se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, më datë xxx, ka regjistruar në regjistrin e veprave penale, emrin e shtetasve A.H., T.H. dhe P.H., për veprën penale të: *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”*, parashikuar si e tillë nga neni 287 i Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr. xxx/xxx dhe më pas çështja është dërguar për gjykim, në ngarkim të shtetasve T.H., A.H., P.H., për veprën penale të mësipërme.

16. Bazuar në aktet dhe provat e mësipërme, gjykata konkludon se, shtetasit F.H. dhe T.H., janë subjekt dhe i hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, sipas nenit 3/1 pikat "ç" dhe "d", pasi F.H., hetohet në shtetin xxx, për zotërim drogash të parashikuara, si të tilla dhe në nenin 283 të Kodit Penal shqiptar, ndërsa, shtetasja T.H., si person i afërt të tij nëna e tij, si dhe për shkak të faktit se, po hetohen për veprën penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”*, parashikuara nga nenin 287 të Kodit Penal shqiptar.

17. Nga pasqyra financiare e administruar, evidentohet fakti se, shtetasi F.H., ka kryer derdhje të disa shumave monetare, në llogari të shtetasve A.H. dhe T.H., të cilët, janë vëllai dhe nëna e tij, dhe ndodhen në xxx. Po ashtu, ka rezultuar se këta shtetas, kanë ndërtuar një objekt, me destinacion karburant dhe shërbime të tjera, autogril, “H.”, në fshatin xxx, si dhe kanë blerë një shtëpi në qytetin e xxx, në një shumë prej xxx euro. Nga gjykimi rezultoi se, blerja e shtëpisë dhe transfertat bankare, janë kryer në kohë, përpara se, shtetasi F.H. të arrestohej në xxx e xxx.

18. Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, xxx, me procesverbalin e datës xxx, është kryer sekuestrimi i kontrates së lidhur, ndërmjet shtetasës T.H., dhe shoqërisë “xxx” sh.p.k, xxx, me administrator E.Xh., nga përmbajtja e të cilës evidentohet fakti se, në datë xxx, shtetasja T.H., (e ëma e shtetasit F. dhe A.H.), ka lidhur një kontratë me palën shitëse: Shoqërinë “xxx” sh.p.k, me administrator E.Xh.. Në nenin 3 të kësaj kontrate, është parashikuar që blerësi, do të blejë një apartament banimi me sipërfaqe xxx m² (sipërfaqe ndërtimore plus sipërfaqe funksionale), apartamenti me nr. xxx, në katin e xxx të banimit, kundrejt shumën prej xxx euro, pagesa e së cilës është parashikuar për t’u dhënë në 2 këste (njëri në datë xxx, në shumën xxx euro, dhe kësti i dytë në datë xxx, në shumën xxx euro).

19. Nga ana e shoqërisë xxx sh.p.k, së bashku me kontratën, janë vënë në dispozicion edhe tre mandat pagese, dhe përkatësisht (mandat pagese me nr. xxx, datë xxx, nr. xxx, datë xxx, dhe nr. xxx, datë xxx). Këto mandate pagese konfirmojnë shlyerjen e plotë, të shumës prej xxx euro të blerjes së banesës dhe pagesat janë kryer nga ana e shtetasës T.H..

20. Po ashtu, është verifikuar nëse këta shtetas, kanë aplikuar për leje ndërtimi pranë Komunës, xxx ku ata jetojnë. Nga dosja e sekuestruar pranë Komunës xxx, ka rezultuar se, në datë xxx, shtetasja T.H., ka paraqitur kërkesë pranë Këshillit të Rregullimit të Territorit të Komunës, xxx, me objekt miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimit, xxx m², xxx.

21. Me vendimin nr. x, datë xxx, të KRRT-ës, komuna xxx, i është miratuar kërkesa për destinacionin dhe sheshin e ndërtimit, kërkueses T.H.. Po ashtu, me vendimin nr. x, datë xxx, KRRT-ja e Komunës xxx ka vendosur t'i japë lejen e ndërtimit shtetasës T.H., në fshatin xxx, me sipërfaqe ndërtimi xxx m², dhe me nr. pasurie xxx/xxx.

22. Ndërkohë që, për kryerjen e ndërtimit sipas lejes së ndërtimit, është ngarkuar shoqëria “xxx” sh.p.k, me përfaqësues ligjor, shtetasin S.Gj. Nga dokumentacioni rezulton se, në datë xxx, shtetasja T.H., ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë xxx sh.p.k, për kryerjen e punimeve të ndërtim montimit. Nga raporti i supervisorit, rezulton që, në bazë të kontratës, shoqëria “xxx” sh.p.k, duhet të përfundonte objektin në datë xxx. Në fakt, objekti rezulton të jetë përfunduar në datë xxx, dhe të jetë marrë në dorëzim nga shtetasja T.H.

23. Me qëllim verifikimin në vend të pasurive të familjarëve të shtetasit F.H., nga ana e organit të prokurorisë, janë këqyrrur pasuritë e mësipërme, nga ku ka rezultuar se, këto objekte janë të përfunduar dhe posedohen nga shtetasit T. dhe A.H.

26. Po ashtu, nga dokumentacioni i sekuestruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive, të Paluajtshme xxx, rezulton se trulli xxx m², mbi të cilin është ngritur karburanti, është blerë në datë xxx, nga shtetasja T. H., në vlerën xxx lekë, tek shtetaset F. dhe Sh.C..

27. Nga kqyrja e vendit të ngjarjes, ka rezultuar se, në posedim të shtetasës T.H., ndodhet një karburant në hyrje të fshatit xxx, një ambjent bosh ngjitur me të, ambjenti xxx, një xxx që gjendet ngjitur me xxx, dhe një ambjent xxx.

28. Po ashtu, nga praktika e zhdoganimit me xxx, datë xxx, rezulton që, të gjitha paisjet që shërbejnë për ambjentin e xxx, janë blerë në xxx, nga shtetasi F.H., në funksion të mobilimit të saj, dhe që dyshohen të jenë si të tilla produkte të veprës penale.

29. Nga të dhënat dhe verifikimet e bëra nga ana e policisë gjyqësore, rezulton se, familja H. ka dhe këto pasuri:

- Një sipërfaqe toke bujqësore, rreth xxx m², e përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”.

- Nga përgjigja e ardhur nga xxx, me shkresën nr. xxx prot, datë xxx, rezulton

se, shtetasi F.Xh.H., ka të regjistruar në pronësi të tij, automjetin e markes xxx, tipi xxx, me targë xxx. Këtë automjet ky shtetas e ka blerë në xxx, në shumën xxx dhrami nga një shtetas xxx. Makinën shtetasi F.H., e ka futur në xxx në muajin xxx të vitit xxx dhe e ka regjistruar në datë xxx.

- Nga përgjigja e ardhur nga ALUIZNI, me shkresën nr. xxx prot, datë xxx, rezulton se, shtetesa T.H. ka aplikuar për legalizimin e:

- Një ndërtesë një katëshe, e ndërtuar në muajin xxx të vitit xxx, sipërfaqe e gjurmës xx m², sip e truallit xxx m².

- Një ndërtesë 2(dy) katëshe, e ndërtuar në muajin xxx të vitit xxx, me sipërfaqe gjurme xxx m², dhe sipërfaqe truallit xxx m².

- Shtetasi F.H. ka aplikuar për legalizimin e një ndërtese një katëshe, e ndërtuar në muajin xxx të vitit xxx, sipërfaqe e gjurmës xxx m², dhe sipërfaqe truallit xxx m².

30. Pasuritë e mësipërme, nuk i janë nënshtruar procedurës së sekuestros të të hetuarve dhe personave të lidhur me to, për shkak të faktit se, janë krijuar para vitit xxx, periudhë në të cilën shtetasi F.H., dyshohet se, kishte filluar aktivitetin kriminal, në xxx e xxx, sipas parashikimit të nenit 3/4 të Ligjit nr. 10192 date 03/12/2009 *“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*, i cili, parashikon se, ai zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që, pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të personit në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

31. Nga hetimi pasuror, i kryer rreth shtetasve T.H., A.H., P.H., F.H., si dhe personave të lidhur me to (sipas nenit 3/2 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009), ka rezultuar se, pas periudhës së përfshirjes së të hetuarit F.H., në xxx e xxx në aktivitet kriminal në fushën e drogave, në xxx, janë krijuar pasuritë e mëposhtëme:

a) Apartament me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja “xxx”, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e dhjetë të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx”, sh.p.k me administrator E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx në shumën prej xxx euro.

b) Pasuri truall, me numër regjistri hipotekor nr. xxx, datë xxx, në emër të të paditurës T.H., me numër xxx/xx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m², e ndodhur në komunën xxx, rrethi xxx.

c) Pasuri e tipit Karburant, me sip. xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të karburantit, në posedim të të të paditurës T.H., ambjent bosh, ambjenti xxx, xxx që gjendet ngjitur me xxx, ambjent xxx, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre të përshkruara në praktikën doganore me nr. xxx, xxx, datë xxx.

32. Nga hetimi pasuror gjithashtu ka rezultuar se:

- Sipas Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) rezulton se, nuk ka ndonjë aktivitet biznesi të regjistruar në emër të familjes H.;

- Sipas Drejtorisë Rajonale Tatimore, xxx, rezulton se, asnjë nga pjesëtarët e familjes H., nuk figuron i regjistruar pranë kësaj Drejtorie;
- Sipas Drejtorisë Rajonale të Punësimit, asnjë pjesëtar i familjes H., nuk figuron i punësuar;
- Nga përgjigjet e ardhura nga QKR, me shkresën nr. xxx prot, datë xxx, rezulton se, asnjë nga pjesëtarët e familjes H., nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin tregtar, si persona fizik apo juridik;
- Nga përgjigja e ardhur nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), me shkresën nr. xxx prot, datë xxx, rezulton se, asnjë nga pjesëtarët e familjes H., nuk kanë aplikuar pranë QKL-së, si përfaqësues ligjor të personit fizik ose të personit juridik të autorizuar;
- Nga përgjigja e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave, me shkresën nr. xxx prot, datë xxx, rezulton se, për të gjitha investigimet financiare të kryera, kanë informuar Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Prokurorinë e rrethit xxx. Në këtë shkresë jepet informacion për pronat që ka sekuestruar prokuroria e rrethit xxx.

33. Në kushtet kur, pasuritë e mësipërme rezultonin se, ishin krijuar pas vitit xxx, vit në të cilin dyshohet se, ka filluar aktiviteti kriminal i shtetasit F.H., në kushtet kur, ekzistonte rrezik real dhe potencial që, ato të tjetërsoheshin apo të humbisnin, për këto pasuri, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. x, datë xxx, është vendosur sekuestrimi i tyre, në bazë të nenit 11/1/a, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009.

34. Nga analiza e akteve të administruara në këtë gjykim, konstatohet, po ashtu, se, nga informacionet e dërguara nga oficeri i kontaktit xxx, konkretisht, në informacionin e dtaës xxx, për të cilin jepet rezerva e mos përdorimit në gjykatë, relatohet se, shtetasi F.H., është arrestuar në vitin xxx, por, pa përmendur datën e arrestimit dhe në të thuhet se, “prokuroria nuk solli asnjë provë”. Më pas, informacioni vazhdon duke përmendur faktin se, shtetasi F.H., nuk u dënua.

35. Në vlerësim të kësaj gjykate, ajo që ka vlerë procedurale dhe e përdorshme në këtë gjykim, janë të dhënat e marra nga kërkesa për ndihmë juridike e autoriteteve gjyqësor britanike, lidhur me veprimtarinë kriminale të shtetasit F.H.. Duke ju referuar përmbledhjes së fakteve përfshirë në këtë letërporosi rezulton e provuar, si më poshtë vijon:

- *“Hetimi nga ana e autoriteteve gjyqësore xxx ka filluar në datë xx xxx xxx, për veprën penale të konspiracionit në furnizimin me droga dhe të kontrolluara dhe pastrim parash.”*

- Sipas relacionit shpjegohet se: *“Ne datën 3 -4 tetor 2011, F.H. do të udhëtonte për në xxx. ...Gjatë pasdites së ditës së martë, x xxx xxx, u qartësua se, H. udhëtoi për në xxx në vëndet e sipërpëmëndura, si dhe një ditë më parë. H. me vonë parkoi makinën në xxx, xxx dhe takoi një mashkull në një klub aty pranë. Së bashku me këtë mashkull, ai hypi në një xxxl xxx të errët dhe u larguan. Më vonë ai u pa duke ngarkuar një pako të madhe me forma të*

parregullta afërsisht xx cm me xxx cm, në bagazhin e makinës së tij të parkuar në xxx. H. më pas u kthye në xxx i vetëm me makinën xxx.

Rrugës së kthimit për në xxx, ai mori në makinë R., në adresën xx xxx xxx dhe të dy shkuan në klubin e natës xxx, në pronësi të R.. Në x xxx forcat e policisë në vazhdimësi të hetimeve, hynë në shtëpinë e R., në adresën xx xxx xxx, për të arrestuar R. dhe H., për dyshime në furnizimin me droga të kontrolluara. Sasi të mëdha të drogave të kontrolluara dhe produkte të tjera u gjetën në këtë adresë.

H. sapo pa policinë u hodh nga dritarja e katit të tretë të ndërtesës dhe ra mbi një sipërfaqe të fortë. Ai vrapoi përmes serës dhe drejt e në duart e një oficeri. Megjithëse i plagosur ai u ndesh me policin dhe arriti të largohej.....Në banesë u gjetën xxx kg kokainë e perzier dhe xxx kg kokainë e papërzier. R. gjatë intervistimit tha se droga ishte e H....në xx xxx H. u ndalua në lagjen xxx xxx."

36. Gjithashtu, në aktet e administruara kë këtë gjykim, rezulton se, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, xxx, me shkresën nr. xxx, datë xxx, është bërë kërkesë për ndihmë juridike në të cilën janë kërkuar dënimet të mëparshme apo dhe arrestime për veprën penale të mbatjes së narkotikëve dhe çfarë lënde narkotike i është sekuestruar shtetasit F.H. Gjithashtu, janë kërkuar të dhëna nëse janë regjistruar procedime penal ndaj këtij shtetasi.

37. Në përgjigje të kësaj letërporosie, autoritetet gjyqësore xxx, me shkresën nr.xxx, datë xxx të Ministrisë së Drejtësisë, kanë kthyer përgjigje, duke dërguar aktet e hetimit penal, të përmëndur dhe më lart.

38. Nga këto akte, nuk rezulton asnjë vendim dënimi i mëparshëm apo informacion për arrestim të mëparshëm, në fushën e narkotikëve për shtetasin F.H.

39. Duke u bazuar në këtë analizë provash të bërë nga gjykata më lart, **organi i prokurorisë, me cilësinë e kërkuesit në këtë gjykim, në diskutimin e saj përfundimtar, ka vlerësuar se, momenti i kryerjes së veprimtarisë kriminale, në fushën e mbatjes së lëndëve narkotike nga shtetasi F.H., për të cilin ekzistojnë indicje të plota të marra në mënyrën e kërkuar nga ligji, (siç janë dy letërporositë e sipërcituara), është data xxx, datë e cila përbën sipas akuzës një e dhënë të saktë lidhur me veprimtarinë kriminale dhe mbi rolin e të hetuarit.**

40. Për pasojë, **sipas organit të prokurorisë, momenti i konsiderimit të pasurive, objekti i procedimit pasuror dhe objekt konfiskimi, në bazë të nenit 3/4 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", do të jenë pasuritë e fituara pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit të mësipërm që i përket shkurtit të vitit 2010.**

41. Bazuar në këtë arsyetim, **prokuroria, në diskutimin e saj përfundimtar vlerëson se, apartamenti me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja "xxx", Rruga "xxx", pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e xxx të banimit, ndërtuar nga shoqëria "xxx", sh.p.k me administrator**

E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx, në shumën prej xxx euro, **nuk duhet jetë objekt konfiskimi, pasi, sipas saj, rezulton të jetë fituar përpara përfishrjes në veprimtarinë së dyshuar kriminale të shtetasit F.H. dhe përpara hyrjes në fuqit të ligjit parandalues, duke hequr dorë nga gjykimi i kërkesës për konfiskimin e kësaj pasurie.**

42. Nga shqyrtimi i çështjes, rezultoi, po ashtu, e provuar se, hetimi në banka dhe shoqëri transfertash, në lidhje me shtetasit F.H. e T.H. dhe familjarët e tyre, nga ku, rezulton se:

- Shtetasja T.H. (nëna e shtetasve F. dhe A.H.), është kliente e bankës xxx dhe ka numër llogarie xxx/lek. Në datë xxx, ka derdhur në llogari shumën xxx lek, të cilën e ka kaluar në depozitë me afat. Në datë xxx, ka tërhequr të gjithë shumën.

- Në numrin e llogarisë xxx/ euro, në datë xxx, shtetasja T.H., ka derdhur shumën xxx euro, të cilën e ka kaluar në depozitë me afat. Në datë xxx, ka tërhequr të gjithë shumën.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka përfituar një transfertë nga I.B., xxx, në shumën xxx euro, ndihmë familjare.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro, për blerje mobilje. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro, për blerje makine. Në datë xxx, ka kaluar shumën xxx euro në depozitë me afat. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka mbyllur depozitën dhe shumën prej xxx euro e ka transferuar në llogari rrjedhëse.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka transferuar në depozitë me afat, shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka derdhur “kesh” shumën xxx euro dhe e ka transferuar shumën në depozitë me afat.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro, për arsyje familjare. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka një derdhje në llogari nga shtetasi Sh.B., në shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase ka mbyllur depozitën me afat dhe ka transferuar shumën xxx euro në një llogari rrjedhëse.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro, për arsyje familjare. Në datë xxx, ka tërhequr shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka depozituar “kesh” shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka kaluar në depozitë, me afat, shumën xxx euro.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka mbyllur para kohe, depozitën dhe ka kaluar shumën, përsëri, në llogari rrjedhëse.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka derdhur cash shumën xxx euro.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka derdhur cash shumën xxx euro, të ardhura personale. Në datë xxx, ka kaluar në depozitë me afat shumën xxx euro.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx euro.

43. Në numërin e llogarisë nr. xxx/lekë, shtetasja T.H. ka kryer këto veprime;

- Në datë xxx, ka derdhur shumën xxx lekë. Në datë xxx, ka derdhur shumën xxx lekë. Në datë xxx, ka derdhur shumën xxx lekë. Në datë xxx, ka derdhur shumën xxx lekë. Në datë xxx, ka derdhur shumën xxx lekë.
- Në datë xxx, ka marrë një kredi në shumën xxx euro, me një afat shlyerje 4 muaj, me destinacion kredie për paradhënie bankare, si kolateral është vendosur depozita me afat xxx euro dhe kredia është shlyer pas një muaji me datë xxx.

44. Në bankën xxx, në numërin e llogarisë xxx/lek, në datë xxx, shtetasja T.H., ka një transfertë, nga dega e thesarit xxx, të quajtur xxx xxx, për shpenzime në shumën xxx lek.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka tërhequr shumën xxx lekë.
- Në datë xxx, kjo shtetase, ka një derdhje në shumën xxx, nga dega e thesarit xxx, xxx xxx.

45. Në bankën xxx, në numrin e llogarisë xxx/ euro, në datë xxx, shtetasja T. H., ka transferta, nga llogaria në llogari, duke këmbyer nga lek në euro, shumën xxx euro, të cilën e ka tërhequr në po të njëjtën datë.

- Në datë xxx, kjo shtetase, ka transferuar nga llogaria në llogari, duke këmbyer shumën xxx euro.
- Nëpërmjet kesaj banke kjo shtetase ka përfiruar edhe tre transferta; Në datë xxx, ka përfituar shumën xxx xxx prej G.A.R. Në datë xxx, ka përfituar shumën xxx xxx prej G.A.R.. Në datë xxx, ka përfituar shumën xxx xxx prej G.A.R.

46. Nga aktet dhe provat e shqyrtuara, ka rezultuar, po ashtu, se, shtetasja T.H., ka marrë shuma të konsiderueshme financiare, të dërguara kryesisht nga shtetasi F.H., por edhe familjarë të tjerë, shuma të cilat kanë ardhur nga kompania xxx dhe të cilat, përmbledhen në tabelën si më poshtë vijon:

Data	Shuma/eur o	Dërgues	Përfitues
06.06.2006	140	F.H (xxx)	T.H.
20.07.2006	283	F.H. (xxx)	T.H.

04.09.200

	575	F.H. (xxx)		T.H.
14.09.2006	500	F.(xxx)	H.	T.H.
10.10.2006	400	F.(xxx)	H.	T.H.
05.02.2007	200	F.(xxx)	H.	T.H.
06.02.2007	400	A.B.		T.H.
12.03.2007	4284	A.H.(xxx)		T.H.
12.03.2007	1600	F.(xxx)	H.	T.H.
09.03.2007	150	A.H.(xxx)		T.H.
18.05.2007	700	F.(xxx)	H.	T.H.
24.05.2007	100	A.H.(xxx)		T.H.
02.06.2007	200	A.H.(xxx)		T.H.
16.07.2007	286	F.H. (xxx)		T.H.
31.07.2007	100	A.H.(xxx)		T.H.
09.08.2007	300	F. (xxx)	H.	T.H.
14.09.2007	200	A.H.(xxx)		T.H.
01.10.2007	643	L. (xxx)	L.	T.H.
20.10.2007	200	A.H.(xxx)		T.H.
01.12.2007	200	A.H.(xxx)		T.H.
24.12.2007	133	F.H. (xxx)		T.H.
29.01.2008	194	F.H. (xxx)		T.H.
07.02.2008	100	F. (xxx)	H.	T.H.
20.02.2008	192	F.H. (xxx)		T.H.
12.03.2008	126	F.H. (xxx)		T.H.

13.05.2008	200	P.H. (xxx)	T.H.
22.07.2008	1000	F.H. (Xxx)	T.H.
24.02.2009	500	A.H.(xxx)	T.H.
21.04.2009	108	F.H. (xxx)	T.H.
12.06.2009	500	T.H.	P.H. (xxx)
20.06.2009	500	T.H.	P.H. (xxx)
09.04.2010	50	T.H.	M.I.
19.06.2010	150	T.H.	M.I.
11.08.2010	100	T.H.	M.I.
16.08.2010	1000	T.H.	A.H. (xxx)
18.08.2010	100	T.H.	M.I.
11.09.2010	100	T.H.	M.I.
29.08.2008	500	P.H. (xxx)	A.H.
19.09.2008	1000	P.H. (xxx)	A.H.
01.12.2008	100	A.C.F.	A.H.
05.12.2008	200	A.C.F.	A.H.
11.09.2009	1500	A.H.	A.C.F.
14.09.2009	1000	R.S.	A.H.
29.10.2009	200	A.H.	A.C.F.
27.11.2009	500	A.H.	A.C.F.
29.12.2009	300	A.H.	A.C.F.
08.01.2010	200	A.H.	A.C.F.
15.01.2010	400	A.H.	A.C.F.
29.01.2010	200	A.H.	A.C.F.
09.02.2010	200	A.H.	A.C.F.
19.02.2010	150	A.H.	A.C.F.
05.03.2010	150	A.H.	J.B.(xxx)
01.04.2010	150	A.H.	A.C.F.
22.09.2010	200	A.H.	A.C.F.
27.09.2010	500	A.H.	A.C.F.
13.10.2010	500	A.H.	A.C.F.
18.10.2010	1200	A.H.	A.C.F.

47. Gjatë gjykimit, përveç provave të sjella nga Prokuroria për Krime të Renda, Tiranë, u administruan dhe vlerësuan nga kjo gjykatë edhe aktet dhe provat që ndodhen në procedimin penal nr. xxx të vitit xxx, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx. Siç u përmënd më lart, kjo prokurori ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurve T.H., A.H., P.H., të akuzuar për kryerjen e veprës penale të: *“Pastrimit të produkteve të veprës penale”*, parashikuar si e tillë nga neni 287 i Kodit Penal.

48. Nga provat e këtij gjykimi, të sjella si prova dhe nga mbrojtja, është dhe akti i ekspertimit vlerësues, i caktuar nga prokuroria e rrethit xxx, me vendimin *“Per kryerjen e ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme”*, të datës xxx. Sipas vendimit të cituar, ekspertës vlerësuese, i është dhënë detyra të përcaktojë vlerën e objektit të ndërtuar, xxxme sip.xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xxx datë xxx, si dhe vendimi nr. xxx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të xxx, në posedim të shtetases T.H.

49. Sipas aktit të ekspertimit vlerësues, është bërë vlerësimi i ndërtimeve të kryera për një kompleks objektësh, si pikë xxx, xxx dhe xxx, të cilat janë brenda truallit me sipërfaqe xxx m², të ndodhura në zonën kadastrale xxx, në fshatin xxx, xxx, pronë e shtetases T.H., dhe sipas llogaritjeve, rezulton që, vlera e këtyre pasurive të jetë xxx (xxx xxx) lekë.

50. Gjithashtu, gjykim janë administruar, nëpërmjet letërporosisë dërguar autorieteve gjyqësore xxx, verifikimet lidhur me dërgesen prej xxx (xxx) eurosh, dërguar nga shtetasja I.B., shtetases T.H., provë kjo e kërkuar dhe nga ana e mbrojtjes në këtë gjykim. Pas verifikimeve të kryera nga policia gjyqësore italiane, rezulton se:

a) *“Shtetasja I.B., ka konfirmuar fitimin e lotarisë, pranë një bari, në rrugën xxx, në xxx, në lotari të menjëhershme “xxx”, nga vajza e saj F.A.C. dhe dhëndri i saj H.A.; Ajo ka specifikuar që në lojë është marrë pjesë, duke përdorur librezën shendetësore të M.L., motiv për të cilin i ishte premtuar shuma prej xxx €, si kompensim për mirësjelljen; Në lidhje me lëvizjet e saj bankare, kjo shtetase, ka deklaruar që, ka marrë nga M.L., në dy pjesë shumën prej xxx € dhe të cilën e ka kaluar më pas, me urdherxhirimi të jashtëm, në shumat xxx €, në favor të T.H., nëna e A.H. dhe xxx €, të bijës F.A.C.;*

Në lidhje me tërheqjen e shumës prej xxx €, të bërë në datë xxx, ajo ka deklaruar që i ka dhënë vajzës së saj F.A.C., shumën prej xxx € dhe ka mbajtur diferencën e mbetur prej xxx € (që i ishte premtuar), të cilën e ka përdorur për blerjen e një pasurie të paluajtshme në xxx (xxx), rruga xxx nr. xx.

Lidhur me tërheqjet e tjera në shuma më të vogla, deklaruesja, ka pohuar që, i ka bërë sipas porosisë së vajzës së saj F.A.C. dhe të dhëndrit A.H., duke jua dhënë atyre shumat e tërhequra;

b) *Shtetasja F.A.C. ka konfirmuar që, ka luajtur në datën xxx së bashku me bashkëshortin A.H., në një bar në xxx, rruga xxx, në llotarine e menjëhershme “xxx”, duke përdorur, meqenëse nuk kishte dokumenta xxx, librezën*

shendetesore të L.M.. Pas fitores, dhe për miresjelljen e treguar, ajo dhe bashkeshorti i kanë dhënë L.M. shumën prej xxx €. Pjesa e mbetur, e barabartë me xxx €, është derdhur në dy pjesë, në llogarinë rrjedhëse me numër xxx, me titullare nënën e saj J.B. Në datën xxx, kjo deklaruese dhe bashkeshorti A.H., i kanë dhënë shtetasës J.B., me urdhërshirim të jashtëm, të drejtën për derdhjen e shumës prej xxx €, në favor të shtetasës T.H., nëna e shtetasit A.H.. Në po këtë datë, ajo ka vendosur transferimin me urdhërshirim të jashtëm, të shumës prej xxx € në llogarinë e saj rrjedhëse, pranë një xxx xxx xxx.

Lidhur me tërheqjen e bërë në datën xxx të shumës prej xxx €, kjo deklaruese, ka konfirmuar që, ka vendosur që t'i dhurojë e nënës së saj B.I. shumën prej xxx €, duke mbajtur diferencën prej xxx €.

c) Shtetasja P.M.K., ka deklaruar që, ka administruar një shoqëri me F.P., bar në xxx, rruga xxx, në të cilin ka dalë loja fituese. Ajo ka deklaruar, gjithashtu, që ka patur një relacion me L.M., nga i cili ka lindur djali, A.F.. Duke konfirmuar lojën fituese, kjo deklaruese ka mbështetur atë që është thënë nga shtetasët J.B. dhe nga F.A.C., lidhur me marrëveshjet me L.M., për marrjen e çmimit dhe kompensimin prej xxx € që ky i fundit ka përfituar për miresjelljen e treguar. Në lidhje me shumën prej xxx €, kjo deklaruese ka thënë që e ka marrë me çek nga L.M.”.

51. Në relacionin e policisë gjyqësore xxx dhe aktet bashkëlidhur atij, nuk është bërë e mundur të vërtetohet se, bileta llotarisë së fituar, është fiktive dhe se në të vërtetë, shtetasi A.H., e ka blerë këtë biletë fituese. Pavarësisht hetimeve, nga verifikimet e kryera nga kjo polici, nuk është bërë e mundur të procedohet shtetasi A.H., për vepra penale në fushën e shpërndarjes apo trafikimit të narkotikeve.

52. Në këto kushte, dërgesa e bërë nga ana e shtetasës B.I. në favor të shtetasës T.H., sipas vlerësimit që bën organi i akuzës, nuk mund të neglizhohet dhe duke e parë shumën e dërguar prej xxx eurosh edhe në raport me konkluzionin e ekspertës vlerësuese, rezulton se, vlera e parave të dërguara nga xxx, është, pothuaj, e barabartë me vlerën e llogaritur nga eksperti për objektin karburant me sip. xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xxx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xxx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të karburantit në posedim të T.H.. E parë kjo vlerë dhe në raport me dërgesat e bëra nga fëmijët të shtetasës T.H., të ndryshme nga ato të dërguara nga F.H. dhe përpara kryerjes së veprës penale të mbatjes së narkotikëve të F.H., sipas akuzës, i bëjnë këto të ardhura më superiore se vlera e këtij ndërtimi.

53. Në kushtet kur, sipas vlerësimit të akuzës, gjatë gjykimit u administruan prova se, për pasurinë xxx me sipërfaqe xxx m², së bashku me ndërtimet lidhëse të xxx, në posedim të shtetasës T.H., personi i tretë dhe familjarët e tij, e justifikojnë fitimin e kësaj pasurie me të ardhura, të cilat nuk provohet se rrjedhin nga veprimtari kriminale, në këtë gjykim nuk

mund të procedohet me konfiskimin e saj dhe për këtë arsye organi i prokurorisë, në diskutimin përfundimtar të çështjes, hoqi dorë nga kërkesa për konfiskimin e tyre.

54. Në përfundim të analizës së akteve dhe provave të cituar më lart, gjykata çmon dhe vlerëson se, në lidhje me pasuritë e mëposhtëme, të cilat ishin objekt konfiskimi:

a) Apartament me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja “xxx”, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e xxx të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx”, sh.p.k me administrator E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx, në shumën prej xxx euro.

b) Pasuri truall, me numër regjistri hipotekor nr. xxx, datë xxx, në emër të të paditurës T.H., me numër xxx/xx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m², e ndodhur në komunën xxx, rrethi xxx.

c) Pasuri e tipit xxx, me sip. xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xxx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xxx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të xxx, në posedim të të të paditurës T.H., ambjent bosh, ambjenti xxx, xxx që gjendet ngjitur me xxx, ambjent xxx, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre,

duke qenë se, organi i prokurorisë, në diskutimin e saj përfundimtar hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës për konfiskim në lidhje me këto pasuri, gjykata, pa i hyrë çështjes në themel dhe pa analizuar nëse këto pretendime të akuzës ishin apo jo mbështetura në prova e ligj, bazuar në nenin nenin 201, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të vendosë në mënyrë tjetër, veçse pushimin e gjykimit.

55. Pargrafi i parë i nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile, parashikon:

“Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

56. Në lidhje me natyrën e këtij gjykim me objekt konfiskim pasurie, i cili, zhvillohet në bazë të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, gjykata e gjen me vend edhe njëherë të theksojë se, pavarësisht se, ky gjykim ka natyrë të veçantë “siu generis”, ai në thelb është një gjykim civil. Duke qenë një gjykim me karakter civil, në rastet kur, subjekti që bën kërkesën ose padinë, e cila, ka si objekt mbrojtjen ose rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm, i cili, sipas ligjit të mësipërm, në këtë rast, është Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë, heq dorë nga gjykimi i padisë ose kërkesës, i vetmi vendim që mund të marrë gjykata, është ai i parashikuar në nenin 201, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, pra, pushimi i gjykimit.

57. Ligji, në këto lloj gjykimesh, nuk i ka lënë të drejtë gjykatës për të vlerësuar dhe çmuar, në lidhje me shkaqet se pse, paditësi ose kërkuesi, heq dorë nga gjykimi i kërkesës së paraqitur para saj (gjykatës), aq më tepër për të vlerësuar nëse këto shkaqe, janë të ligjshme apo jo, por, në zbatim edhe të

parimit të disponibilitetit të parashikuar nga neni 2 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, si dhe janë të lira të heqin dorë në çdo kohë nga gjykimi i padisë, gjykata, në këto raste, është e detyruar që të vendosë pushimin e gjykimit.

58. Në lidhje me sendet e luajtshme objekt konfiskimi, konkretisht, të pajisjeve të palestrës, të përshkruara në praktikën doganore me nr. IM 4, R 3871, datë 26/05/2011, në emër të të paditurit Fatos Hamzaraj, në të cilën përfshihen, këto pajisje, si më poshtë vijon:

*3x tapis roulant Life Fitness 95ti

*3x pajisje për vrap Life Fitness 95xi

*3x biçikleta Life Fitness 95ci

*3x pajisje aerobike Life Fitness 95si

1x pajisje për muskujt e barkut

1x pajisje për forcimin e krahëve

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të krahëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të gjoksit

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të muskujve të gjoksit

1x pajisje për forcim të tricepseve ulur

1x pajisje për forcimin e kofshëve

1x pajisje për forcimin e kofshëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të gjoksit

1x pajisje për forcimin e muskujve të shpinës me tërheqje

1x pajisje për forcimin e muskujve të këmbëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të ulët të shpinës

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të kofshëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të kraharorit

1x pajisje për muskujt e kraharorit/dhe të shpinës

1x pajisje për forcimin e muskujve të jashtëm të këmbëve ulur

1x pajisje për forcimin e muskujve të brendshëm të këmbëve ulur 1 x pajisje për forcimin e muskujve të shpinës ulur

1x pajisje për forcimin e muskujve të shpatullës

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të krahëve me tërheqje 1x pajisje force për ngritje peshash të rënda

5x stola

1x stol për muskujt e barkut

1x mbajtëse peshash dhe shufrash 1x2.5kg-50kg pesha dhe mbajtëse,

gjykata çmon se, kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e tyre, duhet të pranohet sepse:

Së pari: Nga provat e shqyrtuara dhe të cituara nga gjykata në vendimin e mësipërm, rezultoi e provuar se, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që shtetasi F.H., të ketë kryer veprat penale të parashikuara nga germat “ç” dhe “d”, të pikës 1 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin

dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, konkretisht, ekziston dyshimi se, ky shtetas ka kryer veprat penale të: “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” dhe të: “Pastrimit të produktëve të veprës penale”, të parashikuara nga nenet 283 dhe 287 të Kodit Penal.

Së dyti: Nga ana e shtetasit F.H. dhe mbrojtësit të tij, nuk u paraqit asnjë provë, për të provuar se, sendet e mësipërme, objekt konfiskimi, janë fituar në mënyrë të ligjshme prej tij, në kushtet kur, ky shtetas e kishte një detyrim të tillë, sipas pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009.

59. Kjo dispozitë parashikon:

“3. Barra e provës, për të vertetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi”.

60. Gjykata e gjen si të pabazuar në prova dhe ligj, pretendimin e mbrojtjes të ngritur në diskutimin përfundimtar sipas të cilës: “...praktika e letërporosisë provon që, tërësisht, këto sende, nuk janë shlyer ende nga F.H. tek i treti, tek i cili janë marrë. Shtetasi C.M. dhe kompania xxx “xxx”, pretendon që për këtë blerje dhe të tjera sende të sjella, F.H., i ka ende borgj xxx xxx xxx. Rrjedhimisht këto sende nuk janë blerë me para, e nuk na lipset ne të provojmë pastërtinë e tyre, përsa kohë, nuk është përdorur para apo e mirë tjetër materiale për shkëmbim. Shtetasi F.H., përveç aktivitetit të dyshuar kriminal, prej vitesh ka ushtruar aktivitet të provuar dhe të ligjshëm ekonomik, e natyrisht me përfitim ekonomik. E njëjta gjë provohet nga materialet e letërporosisë britanike, tek shpjegohet regjistrimi i biznesit të ligjshëm në emër të F.H. dhe ushtrimi i këtij biznesi po prej tij. ...”

61. Në ndryshim nga mbrojtja, gjykata vlerëson se, gjykimi me objekt konfiskim pasurie, i bazuar në ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si gjykim pasuror ose “in rem”, në ndryshim nga procesi penal ose “in personam”, ka dy palë, që janë organi i prokurorisë për krime të rënda, nga njëra anë dhe personi ndaj të cilit paraqitet kërkesa për konfiskimin e pasurisë, nga ana tjetër, ku, secila prej tyre ka detyrimet e saj ligjore për të përmbushur.

62. Organi i prokurorisë, ka detyrimin ligjor për të provuar para gjykatës, ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicie që, personi ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për konfiskimin e pasurisë, është pjesëmarrës ose ka kryer një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3 i ligjit të mësipërm, gjë të cilën prokuroria e përmbushi në rastin konkret dhe që pranohet edhe nga vetë mbrojtja, në diskutimin përfundimtar, ndërsa, personi ndaj të cilit është paraqitur kërkesa dhe/ose mbrojtja e tij, duhet të paraqesin prova konkrete dhe bindëse, që të tregojnë para gjykatës që sendet ose pasuritë që kërkohen të konfiskohen, janë vënë prej tyre, në mënyrë të ligjshme, gjë të cilën shtetasi F.H. dhe as mbrojtja e tij, nuk arriti që ta realizojë në këtë gjykim.

63. Arsyetimet e bëra nga mbrojtja se, nga shtetasi F.H., nuk janë përdorur

para apo e mirë tjetër materiale, në këmbim të sendeve që kërkohen të konfiskohen, apo arsytimi tjetër sipas të cilit, ky shtetas, përveç aktivitetit të tij të paligjshëm të dyshuar, ka kryer edhe aktivitet tjetër të ligjshëm me përfitim ekonomik në xxx, por, pa sjellë asnjë provë konkrete se sa ka qenë fitimi i realizuar për këtë aktivitet, mbeten thjeshtë në kuadër të pretendimit, të pabazuar në prova dhe nuk mund t'i shërbejnë gjykatës për t'u vendosur në themel të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, në bazë të nenet 2 dhe 201, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile si dhe në nenet 3, 5, 7, 14, 15 deri në 22, 23, 24, 28-38, të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*,

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit, në bazë të nenit 201, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, pasi prokurori hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës, në lidhje me pasuritë:

- a) Apartament me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx lagja “xxx, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e xxx të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx”, sh.p.k me administrator E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx, në shumën prej xxx euro.
- b) Pasuri truall, me numër regjistri hipotekor nr. xxx, datë xxx, në emër të të paditurës T.H., me numër xxx/xx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m², e ndodhur në komunën xxx, rrethi xxx.
- c) Pasuri e tipit xxx, me sip. xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xxx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të karburantit, në posedim të të paditurës T.H., ambjent bosh, ambjenti xxx, xxx që gjendet ngjitur me xxx, ambjent xxx, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre.

2. Revokimin e sekuestros për pasurinë e paluajtshme për objektet:

- a) Apartament me sipërfaqe xxx m², i ndodhur në qytetin e xxx, lagja “xxx”, Rruga “xxx”, pallat xx-katësh, i ndodhur në zonën kadastrale xxx, në katin e xxx të banimit, ndërtuar nga shoqëria “xxx”, sh.p.k me administrator E.Xh., blerë nga e paditura T.H. më datë xxx, në shumën prej xxx euro.
- b) Pasuri truall, me numër regjistri hipotekor nr. xxx, datë xxx, në emër të të paditurës T.H., me numër xxx, e regjistruar në zonën kadastrale xxx, me sipërfaqe xxx m², e ndodhur në komunën xxx, rrethi xxx.
- c) Pasuri e tipit xxx, me sip. xxx m², ndërtuar pas miratimit të sheshit të

ndërtimit nga KKRT-ja e Komunës xxx, me vendimin nr. xx, datë xxx, si dhe vendimi nr. xx, datë xxx për lejen e ndërtimit, së bashku me ndërtimet lidhëse të xxx, në posedim të të të paditurës T.H., ambjent bosh, ambjenti xxx, xxx që gjendet ngjitur me xxx, ambjent xxx, si dhe të gjitha pajisjet brenda tyre.

3. Konfiskimin e pajisjeve të përshkruara në praktikën doganore me nr. xxx, datë xxx, në emër të shtetasit F.H., në të cilën përfshihen, konkretisht, këto sende të luajtshme:

*3x tapis roulant Life Fitness 95ti

*3x pajisje për vrap Life Fitness 95xi

*3x biçikleta Life Fitness 95ci

*3x pajisje aerobike Life Fitness 95si

1x pajisje për muskujt e barkut

1x pajisje për forcimin e krahëve

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të krahëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të gjoksit

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të muskujve të gjoksit

1x pajisje për forcim të tricepseve ulur

1x pajisje për forcimin e kofshëve

1x pajisje për forcimin e kofshëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të gjoksit

1x pajisje për forcimin e muskujve të shpinës me tërheqje

1x pajisje për forcimin e muskujve të këmbëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të ulët të shpinës

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të kofshëve

1x pajisje për forcimin e muskujve të kraharorit

1x pajisje për muskujt e kraharorit/dhe të shpinës

1x pajisje për forcimin e muskujve të jashtëm të këmbëve ulur

1x pajisje për forcimin e muskujve të brendshëm të këmbëve ulur 1 x pajisje për forcimin e muskujve të shpinës ulur

1x pajisje për forcimin e muskujve të shpatullës

1x pajisje për ushtrime të ndryshme të krahëve me tërheqje 1x pajisje force për ngritje peshash të rënda

5x stola

1x stol për muskujt e barkut

1x mbajtëse peshash dhe shufrash 1x2.5kg-50kg pesha dhe mbajtëse.

4. Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet z. A.H., i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave - Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit - xxx.

5. Shpenzimet procedurjale si dhe shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen shtetasve T.H. dhe F.H.

6. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

7. U shpall, në Tiranë, sot me datë 30.10.2013.

**SEKRETARE
LAVDIE HYSAJ**

**GJYQTAR
LUAN HASNEZIRI**